



# **USHTRIMI I FUNKSIONIT ZGJEDHËS/EMËRUES NGA KUVENDI I RSH GJATË VITIT 2023**

## **GJETJE DHE REKOMANDIME**

Zgjedhja/emërimi në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë (2023)

---



Tetor 2023



Ky raport realizohet në kuadër të projektit “Rritja e llogaridhënies së qeverisë përmes një Parlamenti më reagues”, i cili po realizohet nga Fondacioni Westminster për Demokracinë (WFD) me mbështetjen financiare nga Ambasada Britanike në Tiranë. Të gjitha të drejtat për këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

Realizoi

Instituti i Studimeve Politike (ISP)

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

Web: [www.isp.com.al](http://www.isp.com.al)

E-mail: [contactaips@isp.com.al](mailto:contactaips@isp.com.al)

Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies

Adresa: Rr. "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89, K.3, Ap. 16, Tiranë

## **PËRMBAJTJA**

### AKRONIME DHE SHKURTIME

- I. HYRJE
- II. GJETJET KRYESORE
- III. REKOMANDIME
- IV. VLERËSIM I LEGJISLACIONIT DHE PROBLEMATIKËS
- V. ZGJEDHJA NË ORGANET KUSHTETUESE OSE TË KRIJUARA ME LIGJ 2023:  
GJETJET POZITIVE E PROBLEMATIKA

## AKRONIME DHE SHKURTIME

---

KM	Këshilli i Ministrave
AP	Avokati i Popullit
KLGG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KLSH	Kontrulli i Lartë i Shtetit
KMBSH	Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe i Konfliktit të Interesit
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AMA	Autoriteti i Medieve Audiovizive
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
AK/KK	Autoriteti i Konkurrencës/Komisioni i Konkurrencës
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
ERRE	Enti Rregullator i Energjisë
KDRTSH	Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Shqiptar
AIDSSH	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit
ISKPKSH	Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
INSTAT	Instituti i Statistikave
KE	Komisioni Evropian
OSHC	Organizatata e Shoqërisë Civile
KÇLAPDNJ	Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
KEF	Komisioni për Ekonominë dhe Financat
KVPTM	Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
KDAKEP	Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare
KS	Këshilli i Statistikave
SHMI	Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura në Kuvend
GJK	Gjykata Kushtetuese

## I. HYRJE

---

Një prej funksioneve themelore të Kuvendit të RSH është ai zgjedhor. Kuvendi zgjedh Presidentin e Republikës, si dhe një numër të madh funksionarësh të lartë në institucionet kushtetuese ose në institucionet e pavarura të krijuara me ligj. Funkzioni zgjedhor shprehet në vijueshmëri, në varësi nga vakancat e krijuara, si dhe praktikat e përcaktuara nga Kushtetuta, ligjet organike si dhe Rregullorja e Kuvendit.

Gjatë vitit 2023 Instituti i Studimeve Politike (ISP) ka monitoruar bazën ligjore të funksionit zgjedhor të Kuvendit, dokumentet e brendshme rregullatore, ligjet organike dhe praktikat e deritanishme. Procesi paraqitet kompleks dhe lidhet sa me afatet e parashikuara për thirrjen publike, zhvillimin e verifikimeve të dokumentacionit, seancat dëgjimore sipas rastit, si dhe vendimmarrjen finale të Kuvendit në komisione ose në seancën plenare. Nga ana tjetër procesi ndërvarret nga kandidatët dhe numri e cilësia e individëve që aplikojnë për vendet vakante. Po ashtu ndikim të rëndësishëm në proces merr edhe detyrimi ligjor për pjesën më të madhe të kandidatëve për postet e rëndësishme politike dhe institucionale, për mbështetje nga 20 ose 28 deputetë, sipas rastit. Vetë Kuvendi nuk ka një praktikë të unifikuar të raporteve vjetore lidhur me ecurinë e proceseve zgjedhore prej tij apo analiza profesionale mbi gjetjet dhe sugjerimet, bazuar në ushtrimin e kësaj kompetence gjatë viteve të fundit.

Angazhimi i ISP-së është i dyfishtë, - monitorues dhe analizues, dhe ky dokument shpreh gjendjen aktuale, gjetjet kryesore dhe rekomandime përmirësuese për të ardhmen.

Qëllimi i raportit është analiza dhe pasqyrimi i të gjitha problematikave që lidhen me funksionin zgjedhor, si dhe kontributi konstruktiv për komisionet parlamentare, administratën dhe vetë Kuvendin, aktorët politikë në grupet parlamentare, etj, të cilët kanë role dhe përgjegjësi specifike në fazat ndryshme të jetësimit të këtij funksioni.

Gjithashtu qëllimi është edhe adresimi publik i problematikave, duke ofruar informacion cilësor për organizatat e shoqërisë civile që janë pjesë e Regjistrimit të OJF-ve në parlament, për median që raportojnë për Kuvendin dhe nga Kuvendi, për stafet e përfshira në institucionet që janë subjekt zgjedhor në Kuvend, si dhe për të gjitha grupet dhe individët e interesuar.

Vlerësimi, gjetjet dhe rekomandimet do t'i adresohen zyrtarisht Kuvendit dhe institucioneve të përfshira, si dhe i gjithë raporti do të jetë publik në faqen zyrtare në Institutin e Studimeve Politike.

## II. GJETJET KRYESORE

---

Kuvendi i Shqipërisë në fokus të punës së tij ka edhe bashkëveprimin dhe partneritetin me institucionet e pavarura kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj të veçantë. Përmes komisioneve parlamentare Kuvendi ushtron kompetencat e tij kushtetuese të cilat konsistojnë në mbikëqyrjen ndaj këtyre institucioneve si dhe në zgjedhjen/emërimin e titullarëve dhe anëtarëve të organeve të tyre drejtuese. Kushtet dhe kriteret për zgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin e titullarëve dhe anëtarëve të organeve drejtuese të institucioneve të pavarura përcaktohen në kushtetutë dhe/ose ligjet e krijimit, ndërsa procedurat për përzgjedhjen e kandidatave në këto institucione janë të ndryshme dhe bazohen në një kuadër ligjor rregullator.

Nga analiza e bërë në këtë punim lidhur me zgjedhjen, emërimin apo shkarkimin e titullarëve dhe anëtarëve të organeve drejtuese të këtyre institucioneve gjatë vitit 2023 konkludohet sa vijon:

- I. Në disa raste, procedura paraprake e përzgjedhjes nuk ka filluar në afatin e përcaktuar me ligj. Mosrespektimi i afateve, ndonëse nuk prodhon pasoja juridike reflekton mungesë përgjegjësie nga ana e institucionit propozues. Respektimi i afateve është i rëndësishëm për arritjen e objektivit të përcaktuar nga norma kushtetuese dhe/ose ligjore, që është përfundimi i procesit të zgjedhjes/emërimit të kandidatit dhe fillimi i ushtrimit të detyrës prej tij, çka përbën interes publik dhe shtetëror. Kuadri rregullator është i heshtur duke mos parashikuar masa me karakter ndëshkues kur afati i fillimit të procedurës paraprake të përzgjedhjes nuk respektohet nga organi propozues.
- II. Plotësimi i vendeve vakante në organet drejtuese të këtyre institucioneve në shumë raste bëhet në tejkallim të afateve të përcaktuara në ligj apo në Rregulloren e Kuvendit. Mosrespektimi i afateve nga organet e përfshira në procesin zgjedhës/emërues ndikon negativisht në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e vetë institucionit, pavarësisht se ligjet organike garantojnë vazhdimësinë institucionale duke lënë hapësirë për qëndrimin në detyrë të anëtarit të organit deri sa të zëvendësohet. Rastet e shkarkimit apo dorëheqjeve krijojnë boshllëk institucional. Në raste tjera vazhdimësia garantohej vetëm për tre muaj.
- III. Në disa raste, ligji organik nuk parashikon afat për fillimin e procedurave paraprake të përzgjedhjes. Ligji nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare” apo ligji nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar janë ndër rastet. Mungesa e afateve ligjore për fillimin e procedurës paraprake të përzgjedhjes ka si pasojë plotësimin me vonesë të vendeve vakante.
- IV. Në procedurën paraprake të përzgjedhjes së kandidatave, OSHC-të nuk përfshihen. Në praktikën e mira procesi i përzgjedhjes së kandidatave në të gjitha rastet është i hapur dhe publik dhe bazohet në parimin e transparencës, shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës e profesionalizmit. Pjesëmarrja e shoqërisë civile, në cilësinë e vëzhguesit, garanton profesionalizmin dhe transparencën gjatë përzgjedhjes si dhe shmang politizimin.

- V. Kuvendi nuk i përmbahet procedurës së përcaktuar në nenin 111 të Rregullores sipas së cilës Kuvendi organizon dëgjese të hapur publike me të gjithë deputetët pas së cilës përzgjidhen kandidaturat e pëlqyera për t'ia propozuar Kuvendit. Aktualisht përzgjedhja bëhet nga deputetët pas shqyrtimit në komisionin përgjegjës, pra përpara se kandidaturat ti referohen seancës plenare për shqyrtim.
- VI. Ndonëse me akte të brendshme, Kuvendi e ka të detyrueshme publikimin e dokumentacionit të paraqitur nga kandidaturat (CV dhe dokumentet shoqëruese) në asnjë rast ky dokumentacion nuk është vënë në dispozicion të publikut. Transparenca dhe besimi i publikut në këtë kategori njerëzish luajnë rol të rëndësishëm në shtetin e lirë e demokratik. Publiku ka interes të ligjshëm, që përmes transparencës, të informohet më në detaje mbi punën, jetën profesionale dhe veprimtarinë e kandidaturës në fushën që propozohet. Kjo rrit besimin e publikut edhe tek parlamenti.
- VII. Referuar rregullave të procedurës, zhvillimi i seancës dëgjimore është i detyrueshëm por rezulton se në zgjedhjen e anëtarit të AMF-së ky instrument është anashkaluar nga KÇLAPDNJ me arsyetimin se një seancë e tillë (dëgjimore) është zhvilluar në vitin 2018 kur kandidatura garante për mandatin e tij të parë (nga një trupë tjetër legjislative). Ndërkohë Kuvendi ka mbajtur tjetër standard për kandidaturën e AKEP-it e cila edhe kjo garante për një mandat të dytë. Vlerësimi i performancës është vendimtar për të përligjur plotësisht zgjedhjen apo emërimin si anëtar i një organi kushtetues apo të krijuar me ligj. Në këtë proces seanca dëgjimore është një instrument që i shërben këtij qëllimi dhe i vjen në ndihmë deputetëve për të krijuar mundësi njohjeje sa më të plotë dhe të thellë të kandidaturave.
- VIII. Që të jetë efikas dhe i plotë, procesi zgjedhës/emërues kërkon angazhim maksimal nga të gjithë aktorët, njëri prej të cilëve është edhe shoqëria civile. Nga monitorimi i kryer rezulton se kjo e fundit nuk është pjesë e këtij procesi as në fazën e shqyrtimit të kandidaturave në Kuvend nga komisionet parlamentare.
- IX. Përgjithësisht, numri i deputetëve që angazhohen në këtë proces është i ulët dhe se fazat e shqyrtimit reduktohen vetëm në një prezantim shumë të shkurtër të përvojave personale të kandidatëve duke anashkaluar pyetjet dhe debatin parlamentar. Zgjedhja e anëtarëve të KDAKEP-it apo KS janë për tu përmendur. Që të jetë efikas, procesi zgjedhës, kërkon angazhimin maksimal të të gjithë deputetëve. Një angazhim më i madh i tyre tregon prioritetin që i jep Kuvendi këtij procesi por njëkohësisht rrit besimin e publikut në këtë institucion dhe fuqizon transparencën.
- X. Raportet e komisioneve parlamentare në zgjedhjen e titullarëve apo anëtarëve të organeve drejtuese të institucioneve të pavarura mbeten sipërfaqësore dhe joprofesionale. Raporti është produkt i punës së komisionit dhe si i tillë reflekton cilësinë e procesit. Mungon informacioni për kriteret ligjore që duhen plotësuar, si është zbatuar procedura paraprake përzgjedhëse nga organi propozues, përvoja profesionale e kandidaturës, performanca gjatë seancës dëgjimore, pyetjet e drejtuara dhe përgjigjet e marra, mendimet e anëtarëve të komisionit (por edhe të OSHC-ve nëse ka patur) për kandidaturën në fjalë si dhe korrespondenca (nëse ka patur) me institucione të tjera dhe që kanë shërbyer për vlerësimin e kandidaturave. Raporti i komisionit parlamentar në ushtrimin e funksionit zgjedhës nuk është i standardizuar.

- XI. Ndonëse relatori ka përgjegjësinë kryesore në këtë proces, për shkak të rolit të tij që konsiston në verifikimin e plotësimit të kriterëve kushtetuese dhe /ose ligjore si dhe të vlerësimit të meritës së kandidaturës, roli i tij paraqitet i zbehtë duke konfirmuar përpara komisionit thjesht plotësimin ose jo të kriterëve kushtetuese dhe/ose ligjore. (Ky verifikim kryhet nga SHMI).
- XII. I gjithë procesi ezaurohet në një mbledhje të vetme. Në disa raste mbledhja e komisionit parlamentar nuk zgjat më shumë se 10 minuta ku fazat e shqyrtimit reduktohen vetëm në një prezantim tepër të shkurtër të kandidaturës duke anashkaluar pyetjet dhe debatin parlamentar. Kjo tregon një proces jocilësor.
- XIII. Shqyrtimi në seancë plenare reduktohet vetëm në votimin e kandidaturës duke anashkaluar mbi të gjitha diskutimet e deputetëve për këtë çështje të cilat referuar rregullave të procedurës janë detyruese.
- XIV. Për disa institucione, ligji organik parashikon se, në rast të lirimit nga detyra të ndonjërit prej anëtarëve të organit drejtues përpara afatit, mandati i fituar me vendim Kuvendi, zgjat vetëm për periudhën deri në përfundim të mandatit të anëtarit që lirohet. P.sh anëtarët e Bordit Drejtues të AMF-së<sup>1</sup> ose anëtarët e AMA-s<sup>2</sup>. Për sa më sipër, nuk ka një uniformitet përsa i përket kohëzgjatjes së mandatit në të njëjtin organ drejtues. Anëtarë të ndryshëm zgjidhen me kohëzgjatje të ndryshme mandati megjithëse janë anëtarë të të njëjtit organ drejtues (mandat i plotë/mandat i pjesshëm).
- XV. Në ndonjë rast, ligji organik (sikurse ligji për AMF-në<sup>3</sup>) kushtëzon lirimin nga detyra të anëtarit për shkak dorëheqje me vendimmarrjen e Kuvendit. Lirimi nga detyra në këtë rast bëhet me shumicë votash. Heqja dorë nga mandati është veprim që bazohet në shprehjen e vullnetit individual, i cili duhet vetëm të respektohet dhe të mos bëhet objekt diskutimi dhe vendimmarrjeje nga ana e Kuvendit.

---

<sup>1</sup> Shih neni 8 i ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” të ndryshuar” në linkun [https://amf.gov.al/pdf/ligje/Ligjinr\\_95723\\_7\\_2006.pdf](https://amf.gov.al/pdf/ligje/Ligjinr_95723_7_2006.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 29.9.2023)

<sup>2</sup> Shih neni 12, pika 6 i ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar” në linkun <https://ama.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Ligj-nr.97-2013-P%c3%abr-Mediat-Audiovizive-n%c3%ab-Republik%c3%abn-e-Shqip%c3%abris%c3%ab.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 29.9.2023)

<sup>3</sup> Shih: Ligji nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” të ndryshuar” në linkun [https://amf.gov.al/pdf/ligje/Ligjinr\\_95723\\_7\\_2006.pdf](https://amf.gov.al/pdf/ligje/Ligjinr_95723_7_2006.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 30.9.2023)



### III. REKOMANDIME

---

Zgjedhja në organet kushtetuese dhe/ose të krijuara me ligj është një ndër funksionet kushtetuese që ushtron Kuvendi. Këto institucione janë me rëndësi kyçe në sistemet demokratike të qeverisjes dhe ky status kërkon vendosjen e standardeve të larta të profesionalizmit dhe integritetit. Është përgjegjësi e Kuvendit që këtë proces të zhvillojë brenda afateve kushtetuese dhe/ose ligjore duke zgjedhur njerëz profesionistë dhe me integritet<sup>4</sup>.

Duke u nisur nga analiza e gjetjeve në këtë raport, Instituti i Studimeve Politike paraqet në vijim Rekomandime të cilat synojnë plotësimin në kohë të vendeve vakante në organet kushtetuese apo të krijuara me ligj, shmangien e një përbërjeje të politizuar të tyre dhe formimin me anëtarë cilësorë e figura të spikatura, që kanë integritet të lartë profesional dhe etiko-moral dhe që nuk ndikohen nga politika, si dhe ruajtjen dhe forcimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së institucioneve të pavarura me kandidatë të tillë, që është thelbësore për misionin kushtetues dhe ligjor, që ato kryejnë.

1. Kuvendi mund dhe duhet të nisë procedurat, për përzgjedhjen paraprake të kandidaturave për në organet kushtetuese dhe të krijuara me ligj, të paktën tre muaj përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të organit, me qëllim plotësimin në kohë të vendeve vakante. Ndryshimi i rregullave të procedurës nga 45-30 ditë në 3 muaj (neni 111, pika 3) ndihmon procesin duke i lënë hapësirën e nevojshme Kuvendit për të realizuar procedurat parlamentare në shqyrtimin e këtyre çështjeve.
2. Kuvendi mund dhe duhet ti verë para përgjegjësisë organet që kanë kompetencën për të propozuar kandidatura. Në rastet kur këto organe nuk respektojnë afatet kushtetuese apo ligjore për fillimin e procedurave paraprake të përzgjedhjes, Kuvendi, nëpërmjet komisionit përgjegjës parlamentar, duhet ti kërkojë llogari me anë të ushtrimit të mekanizmave të duhur. Zhvillimi i një seance dëgjimore (për raportim) apo kërkesat për informacion ndihmojnë procesin dhe venë para përgjegjësisë organin propozues.
3. Kuvendi mund dhe duhet të angazhohet për të përfshirë shoqërinë civile në këtë proces, si vëzhguese, në fazën paraprake të përzgjedhjes së kandidaturave dhe si pjesëmarrëse, në seancat dëgjimore që zhvillon komisioni përgjegjës me kandidatët. Ky bashkëpunim përmirëson transparencën dhe forcon legjitimitetin dhe besimin e publikut në organin ligjvënës. Përfshirjes së shoqërisë civile në proceset parlamentare i kushtojnë rëndësi të veçantë edhe organizata ndërkombëtare si Unioni

---

<sup>4</sup> Ky është një indikator i rritjes së pavarësisë funksionale në praktikë. Hulumtimet tregojnë se gjatë 20 viteve të fundit në vendet më të mëdha evropiane, politikanët po ndikojnë më pak në zgjedhjen e krerëve të këtyre institucioneve me aktivistë partiakë, por gjithnjë e më shumë po emërojnë persona profesionalë. Shih: Thatcher Mark, Independent regulatory agencies and elected politicians in Europe, in: OECD, Designing Independent and Accountable Regulatory Authorities For High Quality Regulation. Proceedings of an Expert Meeting in London, United Kingdom, 10-11 January 2005, p. 207-208 në linkun <https://www.oecd.org/regreform/regulatory-policy/35028836.pdf>

Ndërparlamentar<sup>5</sup> apo Lëvizja Transparenca Ndërkombëtare<sup>6</sup>. *Referuar Transparency International OSHC-të mund të mbështesin procesin e verifikimit duke hetuar kualifikimin e kandidatëve bazuar në dokumentacionin e paraqitur, si kualifikimet akademike, ashtu edhe historinë e tyre profesionale ose personale që mund të ndikojnë në besueshmërinë e tyre për të kryer punën në mënyrë efektive, në mënyrë të paanshme dhe transparente<sup>7</sup>. Amendimi i nenit 111 të Rregullores së Kuvendit në pikën 2/c ku të parashikohet përfshirja e OSHC-ve si vëzhguese dhe në pikën 4 ku të parashikohet përfshirja e OSHC-ve si pjesëmarrëse në seancën dëgjimore me kandidatët ndihmojnë procesin.*

4. Kuvendi, mund dhe duhet të angazhohet në publikimin e jetëshkrimeve dhe dokumenteve shoqëruese të kandidaturave që propozohen për në organet kushtetuese apo të krijuara me ligj. Kjo fuqizon transparencën dhe rrit besimin e publikut tek parlamenti. Është e rëndësishme që publiku të jetë i bindur për integritetin e kandidaturave. Elementi themelor për krijimin e besimit të publikut, është bindja se kandidaturat janë figura të spikatura që kanë integritet të lartë profesional dhe etiko-moral dhe që nuk ndikohen nga politika.
5. Kuvendi mund dhe duhet, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, të standardizojë me Urdhër të Brendshëm, raportin e komisionit përgjegjës parlamentar në shqyrtimin e kandidaturave për në organet kushtetuese dhe/ose të krijuara me ligj. Raporti është produkt i punës së komisionit dhe si i tillë reflekton cilësinë e procesit. Ai duhet të pasqyrojë një sërë çështjesh si: zbatimin e procedurës paraprake përzgjedhëse nga organi propozues, përvojën profesionale të kandidaturës, performancën gjatë seancës dëgjimore, pyetjet e drejtuara dhe përgjigjet e marra, mendimet e anëtarëve të komisionit (por edhe të OSHC-ve nëse ka patur) për kandidaturën në fjalë si dhe korrespondencën (nëse ka patur) me institucione të tjera dhe që kanë shërbyer për vlerësimin e kandidaturave.
6. Deputetët duhet të angazhohen më shumë në drejtim të zgjedhjes apo emërimit të titullarëve apo anëtarëve të organeve drejtuese të institucioneve të pavarura dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në këtë proces si në komisione ashtu edhe në seancë plenare. Një angazhim më i madh i tyre tregon prioritetin që i jep Kuvendi këtij procesi por njëkohësisht rrit besimin e publikut tek parlamenti dhe fuqizon transparencën. Propozimi i kandidaturave me integritet dhe profesionalizëm dhe të pandikuar nga politika kërkon vullnet politik. Pyetjet drejtuar kandidaturave, diskutimet konstruktive dhe cilësore rreth përvojave profesionale si dhe hetimi i kualifikimeve të kandidatëve ndikojnë në njohjen e thelluar të tyre dhe e bëjnë procesin më cilësor.
7. Kuvendi ka të drejtën dhe detyrimin që t'ia nënshtrojë debatit parlamentar propozimet për në organet kushtetuese dhe/ose të krijuara me ligj. Diskutimet shërbejnë edhe si

---

<sup>5</sup> Shih Global Parliamentary Report 2022 në linkun <https://www.ipu.org/resources/publications/reports/2022-03/global-parliamentary-report-2022> (Aksesuar për herë fundit më 28.4.2023) fq. 381

<sup>6</sup> Shih Civil society interventions to enhance parliamentary oversight. Transparency International - 2022 në linkun <https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/kproducts/CSO-interventions-to-enhance-parliamentary-oversight.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 27.9.2023)

<sup>7</sup> Po aty fq. 8 cit.

një instrument që publiku të njohë më shumë kandidaturat e propozuara dhe të vlerësojë zgjedhjen ose jo të tyre në institucionin ku garojnë.

8. Kuvendi mund dhe duhet të bëjë ndërhyrjet e nevojshme legjislative, në disa ligje organike, duke parashikuar sa vijon:
  - Shfuqizimin e dispozitave në lidhje me mandatin e pjesshëm. Anëtarët e të njëjtit organ drejtues duhet të gëzojnë mandat të barabartë.
  - Shfuqizimin e kompetencës së Kuvendit për ta liruar nga detyra, anëtarin e organit drejtues që ka dhënë dorëheqje, me vendim Kuvendi (me shumicë votash).
  - Parashikimin e afatit brenda së cilit organi propozues duhet të fillojë procedurat paraprake të përzgjedhjes së kandidaturave.

#### IV. VLERËSIM I LEGJISLACIONIT DHE PROBLEMATIKËS

---

Kushtetuta dhe ligje të posaçme i atribuojnë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (në vijim Kuvendi) edhe funksionin zgjedhës/emërues (shkarkues), funksion i cili nënkupton zgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj. Kuvendi si institucioni më i lartë ligjvënës ka përgjegjësinë në miratimin e programit politik dhe përbërjes së Këshillit të Ministrave, në zgjedhjen e Presidentit të Republikës, Avokatit të Popullit, Prokurorit të Përgjithshëm, organeve kushtetuese të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve<sup>8</sup>, disa prej anëtarëve të organeve të sistemit të drejtësisë<sup>9</sup>, kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Këshillit Drejtues të Radio Televizionit, Autoritetit të Mediave Audiovizive, Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Komisionit të Konkurrencës, Komisionit të Prokurimit Publik etj.

Institucionet kushtetuese dhe institucionet e krijuara me ligj, zgjedhja e të cilave bëhet nga Kuvendi, kryesohen nga titullari apo organi drejtues kolegjial (Bord, Këshill, Komision), të cilët drejojnë politikën institucionale për fushën ligjore që mbulojnë, punën administrative dhe kontrolluese në institucion. Referuar kushtetutës dhe ligjeve të posaçme, institucionet që zgjidhen nga Kuvendi, në varësi të formës së ndërtimit, kategorizohen si më poshtë:

- Monokratike ku përfshihen: Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Shërbimin Civil, Prokurori i Përgjithshëm etj.
- Kolegjiale ku përfshihen: Agjencia e Sigurimit të Depozitave, Autoriteti i Konkurrencës, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoriteti i Medieve Audiovizive, Banka e Shqipërisë, Enti Rregullator i Energjisë etj.

Numri i anëtarëve të organit drejtues përcaktohet në kushtetutë dhe/ose në ligjet që i themelojnë këto institucione.

Kushtet dhe kriteret për zgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin e titullarëve dhe anëtarëve të organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura që zgjidhen nga Kuvendi përcaktohen në kushtetutë dhe/ose ligjet e krijimit, ndërsa procesi i zgjedhjes/emërimit apo i shkarkimit bazohet në kuadrin ligjor rregullator të mëposhtëm:

- Kushtetuta<sup>10</sup>;

---

<sup>8</sup> Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Komisionerëve Publikë, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

<sup>9</sup> Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe atij Gjyqësor, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, 3 anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>10</sup> Neni 6/1 dhe 45/3 (dekriminalizimi), Neni 61 për Avokatin e Popullit, neni 125 për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, neni 147 për 5 anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, neni 147/d për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, neni 148/a për Prokurorin e Përgjithshëm, neni 149 për 5 anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, neni 161 për Guvernerin e Bankës së Shqipërisë dhe Këshillin Mbikëqyrës, neni 162 për kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni C (Aneksi) për organet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve: Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Komisionerët Publikë dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

- Rregullorja e Kuvendit<sup>11</sup>;
- Ligjet organike që themelojnë këto institucione<sup>12</sup>;
- Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- Ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” të ndryshuar<sup>13</sup>”.

Ushtrimi i funksionit zgjedhës/emërues nga Kuvendi lidhet domosdoshmërisht me kryerjen e procedurave përkatëse. Standardi kushtetues apo ligjor në drejtim të plotësimit të vakancave në institucione kushtetuese apo të krijuara me ligj parashikon një procedurë që nga pikëpamja e organeve që marrin pjesë në këtë proces, mund të jetë plurale ose individuale. Kjo është karakteristikë për Kushtetutat dhe ligjet që përcaktojnë regjimin e një shteti demokratik të së drejtës. Procedurat kushtetuese apo ligjore përsa i përket formimit/konstituimit të një organi kushtetues apo ligjor në esencë karakterizohen ose si një procedurë ekskluzivisht parlamentare ku hyn në lojë pluralizmi konkurrencial i partive politike që marrin pjesë dhe rrjedhimisht nevoja për kërkimin e një konsensusi midis tyre<sup>13</sup> ose në raste të tjera nga angazhimi institucional i dy ose më shumë organeve<sup>14</sup> ku secili prej tyre i udhëhequr nga parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe ai i luajalitetit kushtetues, në ushtrimin e kompetencës për pjesën që i përket, vepron sipas rolit kushtetues apo ligjor.

Kushtetuta dhe ligje të posaçme kanë parashikuar qartë edhe rastet se kur mund të shkarkohet apo largohet nga detyra para mbarimit të afatit anëtari i organit kushtetues apo i krijuar me ligj. Kuadri rregullator i mësipërm parashikon një procedurë strikte dhe të detyrueshme për tu respektuar nga organi më i lartë ligjvënës për shkarkimin e subjekteve që kanë pozicione kushtetuese apo në një organ të krijuar me ligj. Funksioni që kryen Kuvendi në këtë rast është i një natyre të veçantë. Procesi i realizuar prej Kuvendit ndryshon nga gjithë veprimtaria e tij e zakonshme si një organ që miraton ligje. Ky proces ligjor që është një proces gjyqimi disiplinor dhe i ngjashëm me procedurat hetimore administrative ka parimet e veta, të cilat lidhen me verifikimin, analizën dhe vërtetimin e atyre shkaqeve konkretë që kanë shërbyer për organin kompetent për të marrë masën e shkarkimit nga detyra të organit kushtetues apo atij të krijuar me ligj<sup>15</sup>.

<sup>11</sup> Neni 111.

<sup>12</sup> Ligji nr. 9049/2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” të ndryshuar<sup>13</sup>” (neni 17), ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar<sup>13</sup>” (neni 12), ligji nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar<sup>13</sup>” (neni 23), ligji nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar<sup>13</sup>” (neni 33), ligji nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar<sup>13</sup>” (neni 21/3), ligji nr. 9572/2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” të ndryshuar<sup>13</sup>” (neni 6), ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar<sup>13</sup>” (neni 8), ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (neni 25/2), ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” (neni 16 dhe 22), ligji nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar<sup>13</sup>” (neni 114/3), ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar<sup>13</sup>” (neni 11), ligji nr. 10 242/2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri” (neni 8/1), ligji nr. 10019/2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar<sup>13</sup>” (nenet 13, 15, 16), ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” të ndryshuar<sup>13</sup>” (neni 8/1).

<sup>13</sup> Zgjedhja e Avokatit të Popullit është rast tipik ku kandidaturat propozohen nga grupe deputetësh me jo më pak se 28 deputetë.

<sup>14</sup> Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe atij Gjyqësor, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, 3 anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese ku kandidaturat propozohen nga organe të ndryshme duke përfshirë edhe KED si institucion që angazhohet në këtë proces në verifikimin e përmbushjes së kritereve kushtetuese dhe ligjore për zgjedhje.

<sup>15</sup> Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 75/2002 cit.

## V. ZGJEDHJA NË ORGANET KUSHTETUESE OSE TË KRIJUARA ME LIGJ 2023: GJETJET POZITIVE E PROBLEMATIKA<sup>16</sup>

Kuvendi gjatë vitit 2023 në ushtrim të funksionit zgjedhës ka përmbushur detyrimin ligjor për zgjedhjen e disa kandidaturave të paraqitura. Institucionet që kanë pësuar ndryshime në përbërjen e organit të tyre drejtues (Bord, Këshill) janë: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare<sup>17</sup>, Instituti i Statistikave<sup>18</sup> dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare<sup>19</sup>. Ndërkohë, aktualisht, rezulton se një sërë institucioneve të tjera kushtetuese apo të krijuara me ligj kanë vende vakante në organet e tyre drejtuese si AP, ISKPKSH, KK, KPP, KMD, KDRTSH, KLGJ, KLP, INSTAT, Komisionerët e AP-së, ERRE etj<sup>20</sup>. Mosplotësimi në kohë i vendeve vakante në organet drejtuese të këtyre institucioneve është një ndër shqetësimet e ngritura edhe në raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë<sup>21</sup>.

1. Një moment i rëndësishëm dhe që kërkon vëmendje është shkalla e respektimit të afatit për fillimin e procedurës paraprake të përzgjedhjes. **Sipas Rregullores së Kuvendit<sup>22</sup> kandidaturat për në organet kushtetuese apo të krijuara me ligj duhet të propozohen 45 deri në 30 ditë përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të organit dhe jo më vonë se 10 ditë pas shkarkimit të anëtarit të organit.** Njëkohësisht edhe ligjet organike, përgjithësisht, parashikojnë afate kohore për nisjen e procedurës nga propozuesi, megjithëse në disa raste afati bie ndesh me dispozitën e mësipërme të Rregullores së Kuvendit. P.sh afati për fillimin e procedurës për zgjedhjen e anëtarit të AMF-së apo të KK-së sipas ligjit organik është tre muaj<sup>23</sup>.
2. Mosrespektimi i afateve, ndonëse nuk prodhon pasoja juridike reflekton mungesë përgjegjësie nga ana e institucionit propozues, njëkohësisht ndikon negativisht në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e vetë institucionit. Nga ana tjetër duhet nënvizuar se propozimi me vonesë ngre dyshime për ndikim politik. Propozimi për anëtarët të

<sup>16</sup> Nuk janë pjesë e këtij punimi ndryshimet në kabinetin qeveritar.

<sup>17</sup> Vendim nr. 17/2023 “Për emërimin e zotit Ildir Gjata anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”

<sup>18</sup> Vendim nr. 32/2023 “Për emërimin në detyrë të zotit Adrian Kamenica si anëtar i Këshillit të Statistikave”;

Vendim nr. 33/2023 “Për emërimin në detyrë të zotit Edvin Zhllima si anëtar i Këshillit të Statistikave”;

Vendim nr. 34/2023 “Për emërimin në detyrë të zonjës Elora Kokalari si anëtare e Këshillit të Statistikave”;

Vendim nr. 35/2023 “Për emërimin në detyrë të zonjës Kozeta Sevrani si anëtare e Këshillit të Statistikave”.

<sup>19</sup> Vendim nr. 103/2023 “Për zgjedhjen e zonjës Edlira Dvorani anëtare të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”.

Vendim nr. 104/2023 “Për zgjedhjen e zotit Armer Juka anëtar të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”.

Vendim nr. 105/2023 “Për zgjedhjen e zotit Bleron Dokle anëtar të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”.

<sup>20</sup> Ndonëse vendet vakante janë parashikuar në kalendarin e punimeve të Kuvendit, ky i fundit nuk ka të përcaktuar datën e shqyrtimit të tyre në seancë plenare. Për më tepër kalendarin nuk përcakton as komisionet përgjegjëse të ngarkuara me shqyrtimin e kandidaturave dhe as datat e depozitimit të tyre në Kuvend. Nga ana tjetër as faqja e Kuvendit në rubrikat përkatëse nuk jep informacion në lidhje me këto kandidatura.

<sup>21</sup> Progres raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2022. (Aksesuar për herë të fundit më 29.3.2023) <https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/63-progres-raportet>

<sup>22</sup> Rregullore e Kuvendit, Neni 111

<sup>23</sup> Neni 7 i ligjit organik (AMF) sipas së cilit “*Tre muaj para përfundimit të mandatit të çdo anëtari të Bordit, Autoriteti njofton me shkrim Kuvendin, i cili fillon praktikat për zgjedhjen e anëtarit të ri*”.

Neni 21, pika 3/1 i ligjit organik (Për mbrojtjen e konkurrencës) sipas së cilit “*Tre muaj para përfundimit të mandatit të çdo anëtari të komisionit, autoriteti njofton me shkrim Kuvendin, i cili fillon praktikat për zgjedhjen e anëtarit të ri*”.

AKEP-it nga KM, si organ propozues, është një ndër rastet. Megjithëse në dispozitat e ligjit organik nuk ka asgjë të shkruar lidhur me afatin për nisjen e procedurës paraprake të përzgjedhjes, KM duhet ta kish nisur më herët procedurën me qëllim përzgjedhjen e anëtarëve në kohën e duhur duke i lënë kohë të mjaftueshme edhe Kuvendit për të zhvilluar procedurat parlamentare si organ i emërtesës<sup>24</sup>. Rezulton se KM i ka propozuar kandidaturat në muajin korrik me VKM nr. 412 datë 7.7.2023 “Për propozimin Kuvendit për emërimin e disa anëtarëve të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” ndërkohë që anëtarëve në detyrë, konkretisht E. Dvorani dhe K. Topçiu u mbaronte mandati në prill dhe maj 2023, ndërsa anëtari tjetër Xh. Lilaj ka dhënë dorëheqjen në shkurt 2023. Me përfundimin e procesit brenda afateve kushtetuese apo ligjore sigurohet edhe mirëfunksionimi i institucionit, me një anëtarësi dhe përbërje të plotë, në përputhje me ligjin, shmangët krijimi i boshllëkut institucional dhe garantohet vazhdimësia e veprimtarisë së institucionit përkatës<sup>25</sup>.

**Në këtë drejtim, kuadri rregullator është i heshtur duke mos parashikuar masa me karakter ndëshkues kur afati i fillimit të procedurës paraprake të përzgjedhjes nuk respektohet nga organi propozues.**

- 3. Në raste të tjera, ndonëse afati kushtetues/ligjor për nisjen e procedurave paraprake përzgjedhëse respektohet, kandidatura përsëri nuk zgjidhet në kohë.** Rasti i anëtarit të Komisionit të Konkurrencës është njëri prej tyre<sup>26</sup>. Kuvendi ka shpallur vakancën e krijuar në këtë institucion më 6 dhjetor 2022 meqenëse mandati i anëtarit mbaronte më 25.1.2023 duke përcaktuar edhe datën 27 dhjetor të vitit 2022 si afatin përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit të secilit prej kandidatëve. Kandidaturat e vetofruara ndonëse u shqyrtuan në komisionin përgjegjës (për Ekonominë dhe Financat) më 31.1.2023 dhe i kaluan seancës plenare për shqyrtim më 23.2.2023 ende sot nuk janë zgjedhur. Fakti, që çështja, u hoq nga rendi i ditës, gjatë punimeve parlamentare, pa asnjë arsye dhe mbi të gjitha pa vendimarrje Kuvendi<sup>27</sup> (në shkelje të rregullave të procedurës) dëshmon qartazi se ka ndikim politik.
- 4. Nga ana tjetër, një pjesë e ligjeve organike (ligji për AKEP është ndër rastet) nuk autorizojnë subjektin propozues për të miratuar rregulla të detajuara për procedurën përzgjedhëse në rastet e kandidimit për vendet vakante në këto**

---

<sup>24</sup> Shih procesverbalin e KVPTM datë 13.9.2023 në linkun <https://web-api.parlament.al/Files/202309190902578125Raporti%20i%20komisionit%20p%C3%ABr%20Veprimtarit%C3%AB%20Prodhuese,%20Tregtin%C3%AB%20dhe%20Mjedisin%20.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 27.9.2023)

<sup>25</sup> Kushtetuta apo disa nga ligjet organike garantojnë vazhdimësinë institucionale duke lënë hapësirë për qëndrimin në detyrë të anëtarit të organit derisa të zëvendësohet. Në rastet e shkarkimeve apo dorëheqjeve vazhdimësia institucionale nuk garantohet. Në disa raste si AMF vazhdimësia garantohet edhe pas përfundimit të mandatit por jo më shumë se tre muaj. Shih ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” të ndryshuar<sup>28</sup>, neni 7.

<sup>26</sup> Kandidaturat e vetofruara janë Adriana Berberi dhe Ergys Misha

<sup>27</sup> Shih: Procesverbal i seancës plenare datë 23.2.2023 fq. 54 në linkun <https://web-api.parlament.al/Files/202303021337379253Procesverbal,%20dat%C3%AB%2023.2.2023.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 30.9.2023)

**institucione**<sup>28</sup>. Pavarësisht se kjo nuk e ka penguar propozuesin (në këtë rast KM) të bëjë shpalljen e vakancës<sup>29</sup>, përsëri procesi mbetet jotransparent. Edhe në rastet kur këto rregulla janë miratuar OSHC-të nuk janë përfshirë në këtë proces. Në praktikën e mira ndërkombëtare procesi i përzgjedhjes së kandidaturave në të gjitha rastet është i hapur dhe publik dhe bazohet në parimin e transparencës, shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës e profesionalizmit. Pjesëmarrja e shoqërisë civile, në cilësinë e vëzhguesit, garanton profesionalizmin dhe transparencën gjatë përzgjedhjes si dhe shmang politizimin. E njëjta problematikë rezulton të jetë edhe në Kuvend, kur ky i fundit është edhe në cilësinë e organit propozues.

Referuar rregullave të procedurës, Kuvendi bën shpalljen dhe publikimin e vakancës në faqen e Kuvendit në internet për një afat 20 ditor, pas së cilit kandidaturat e vetofruara u bëhen të njohur anëtarëve të Kuvendit me qëllim organizimin brenda 5 ditëve të dëgjësës së hapur **publike** në mjediset e Kuvendit ku ftohen të marrin pjesë të gjithë deputetët/grupet parlamentare. Të paktën 28 deputetë përzgjedhin kandidatin/kandidatët, që do të mbështesin për t'ia propozuar Kuvendit, sipas cilësive profesionale dhe performancës gjatë prezantimit.<sup>30</sup>

1. Nga monitorimet e kryera nga Instituti i Studimeve Politike rezulton se Kuvendi, në vitin 2019, ndonëse ka miratuar këtë procedurë paraprake të përzgjedhjes së kandidaturave, në asnjë rast nuk e ka zbatuar plotësisht atë. Kuvendi, në këtë fazë, është mjaftuar vetëm me shpalljen dhe publikimin e vakancës **ndërsa seancat dëgjimore publike në funksion të përzgjedhjes së kandidaturave nuk janë zhvilluar në asnjë rast**. Pavarësisht shpalljes së vakancës procesi mbetet jo transparent. Rasti i zgjedhjes së anëtarit të AMF-së në mars 2023 është njëri prej tyre.
2. Kuvendi, në cilësinë e organit të emërtesës dhe në respektim të afatit të parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, nëpërmjet Komisionit për Çështje Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (në vijim KÇLAPDNJ), si propozues, ka ndërmarrë nismën për hapjen e procedurave të aplikimit duke bërë shpalljen dhe publikimin e vakancës së anëtarit të Bordit të AMF-së në faqen e Kuvendit në internet për një afat 20 ditor. Shpallja i referohet datës 15.12.2022 ndërsa anëtarit në detyrë i përfundonte mandati në 25 janar 2023<sup>31</sup>. Njoftimi përkatës është shoqëruar me kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë kandidati si dhe afatin përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit. Pas kësaj, lista e kandidaturave të vetofruara duhej tu ishte bërë e njohur anëtarëve të Kuvendit me qëllim organizimin e dëgjësës së hapur **publike**. Sipas Rregullores, kandidaturat, që marrin mbështetjen me firma të jo më pak se 28 deputetëve, depozitohen zyrtarisht në protokollin e Kuvendit dhe nisin *rrugëtimin* e shqyrtimit në komision e seancë plenare.

---

<sup>28</sup> Edhe në rastet kur ligji autorizon nxjerrjen e rregullave, këto nuk parashikojnë përfshirjen e publikut (OSHC). Përmendim psh VKM nr. 670, datë 7.11.2018 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”. Kandidaturat u miratuan nga Kuvendi në maj 2023. Shih linkun <https://www.instat.gov.al/media/6199/vendimi-nr-670-dat%C3%AB-7112018.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 27.9.2023)

<sup>29</sup> Shih: shpalljen e vakancave për anëtarë të AKEP-it nga KM në linkun <https://www.kryeministria.al/neesroom/njoftim-per-aplikim-12/> (Aksesuar për herë të fundit më 27.9.2023)

<sup>30</sup> Neni 111 pika 2 shkronja c - Rregullore Kuvendi

<sup>31</sup> Vendim nr. 5, datë 25.1.2018 “Për emërimin e zotit Ildir Gjata anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”. Mandati është 5-vjeçar.



**Të dhënat monitoruese tregojnë se Kuvendi nuk i përmbahet procedurës së mësipërme të parashikuar duke e lënë mbështetjen për kandidaturën e vetofruar pas shqyrtimit në komisionin përgjegjës, pra përpara se kandidaturat ti referohen seancës plenare për shqyrtim.** Përfshirja e publikut (veçanërisht OSHC-ve) në procedurën paraprake të përzgjedhjes fuqizon transparencën, rrit besimin e tij tek parlamenti, si dhe imponon respektimin e afateve ligjore dhe përzgjedhjen e kandidatëve profesionalë, të pavarur nga politika dhe me integritet të lartë moral.

1. Planifikimi dhe zbatimi i procedurave të përzgjedhjes së kandidaturave janë informacion me interes publik, në përputhje edhe me kuadrin ligjor për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare. Publiku ka të drejtë të kërkojë e të marrë sqarime nga Kuvendi në lidhje me zbatimin e procedurës përzgjedhëse. Përzgjedhja e komisionerëve të AP-së është për tu marrë në konsideratë. Organizimi i procesit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave kryhet nga Avokati i Popullit, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut<sup>32</sup>.
2. **Ndonëse me akte të brendshme<sup>33</sup>, Kuvendi e ka të detyrueshme publikimin e dokumentacionit të paraqitur nga kandidaturat (CV dhe dokumentet shoqëruese) në asnjë rast ky dokumentacion nuk është vënë në dispozicion të publikut.** Transparenca dhe besimi i publikut në këtë kategori njerëzish luajnë rol të rëndësishëm në shtetin e lirë e demokratik. Publiku ka interes të ligjshëm, që përmes transparencës, të informohet më në detaje mbi punën, jetën profesionale dhe veprimtarinë e kandidaturës në fushën që propozohet. Megjithëse të dhënat në CV kanë karakter personal dhe për rrjedhojë, ato përfshihen në hapësirën e gjerë që mbron neni 35 i Kushtetutës<sup>34</sup>, ato mund të bëhen publike duke i redaktuar më parë ose duke i kërkuar paraprakisht kandidaturës pëlqimin për publikimin e saj. Të dhënat monitoruese tregojnë se në disa raste komisionet përgjegjëse kanë paraqitur në raportin e tyre një përmbledhje shumë të shkurtër të eksperiencës profesionale të kandidaturave (p.sh rasti kandidatëve për KDAKEP-it)<sup>35</sup>. Në raste të tjera, edhe kjo përmbledhje shumë e shkurtër, mungon (p.sh rasti kandidatëve për KS). Mënyra e zgjedhjes së titullarëve apo organeve drejtuese ka rëndësi edhe për sigurimin e funksionimit të këtyre institucioneve. Gjithçka fillon me mënyrën se si zgjidhen këto organe.

<sup>32</sup> Ligji nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” të ndryshuar”.

<sup>33</sup> Vendim i Byrosë së Kuvendit nr. 5, datë 12.02.2014 "Për miratimin e Rregullores për funksionimin e faqes zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë" (neni 3)

<sup>34</sup> Neni 35 - Kushtetutë në linkun <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>

1. Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij.

2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

3. Kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

4. Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin.

<sup>35</sup> Shih raportin e KVPTM në linkun <https://web-api.parlament.al/Files/202309190902578125Raporti%20i%20komisionit%20p%C3%ABr%20Veprimtarit%C3%AB%20Prodhuese,%20Tregtin%C3%AB%20dhe%20Mjedisin%20.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më

27.9.2023)

Me paraqitjen e kandidaturave, Kryetari i Kuvendit ia kalon ato menjëherë komisionit përkatës me qëllim zhvillimin e seancave dëgjimore me secilin kandidat<sup>36</sup>. **Organizimi i seancave dëgjimore publike është bërë vitet e fundit një praktikë e njohur në Kuvend.** Komisionet parlamentare i zhvillojnë seancat dëgjimore bazuar në kalendarin e miratuar për këtë qëllim. Stafi i komisionit përgatit njoftimet për kandidatët i cili përmban datën, orën dhe vendin e zhvillimit të seancës dëgjimore, të cilat në çdo rast, janë publike për ti dhënë procesit sa më shumë integritet dhe besueshmëri.

1. Transparenca dhe publiciteti që karakterizojnë procesin e zgjedhjes apo emërimit janë elementë që kontribuojnë drejtpërdrejt në cilësinë e institucioneve (si të Kuvendit që i zgjedh ashtu edhe të institucionit për të cilin zgjidhen kandidaturat), dhe në veçanti në perceptimin dhe forcimin e besimit të publikut tek këto institucione. **Një planifikim paraprak i jep të gjithë kohën e nevojshme si kandidaturës për tu përgatitur ashtu edhe deputetëve për tu njohur me dokumentacionin e kandidatit, dhe për të përgatitur pyetjet.** Për të realizuar një proces sa më efikas përkrah komisionit qëndron Shërbimi i Monitorimit në Kuvend, strukturë përgjegjëse për të ndihmuar Kuvendin dhe organet e tij në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës parlamentar mbi organet e pavarura kushtetuese dhe institucionet e tjera të pavarura të krijuara me ligj si dhe zgjedhjen e këtyre organeve. Verifikimi i përmbushjes së kriterëve ligjore bëhet paraprakisht nga ky shërbim.
2. Kuvendi në zgjedhjen e kandidaturave, nuk kufizohet vetëm në aspektin formal dmth nëse janë respektuar kriteret kushtetuese dhe ligjore të kërkuara. Kompetenca e Kuvendit, për një shqyrtim të plotë, shtrihet edhe në këndvështrimin e meritës së kandidaturave dhe kjo është në përputhje me formën e regjimit politik të përcaktuar me Kushtetutë - si Republikë Parlamentare. Vlerësimi i performancës është vendimtar për të përligjur plotësisht zgjedhjen apo emërimin si anëtar i një organi kushtetues apo të krijuar me ligj. Në këtë proces seanca dëgjimore është një instrument që i shërben këtij qëllimi dhe i vjen në ndihmë deputetëve për të krijuar mundësi njohjeje sa më të plotë dhe të thellë të kandidaturave. Gjatë seancës dëgjimore anëtarët e komisionit parlamentar njihen me veprimtarinë dhe përvojat personale të kandidatëve në detyrat e ushtruara dhe vizionin në drejtimin e institucionit për të cilin kandidojnë. Për të marrë informacionet e nevojshme deputetët kanë të drejtë ti drejtojnë pyetje kandidatëve.
3. **Ndonëse zhvillimi i seancës dëgjimore është i detyrueshëm, nga të dhënat monitoruese rezulton se në zgjedhjen e anëtarit të AMF-së ky instrument është anashkaluar nga KÇLAPDNJ me arsyetimin se një seancë e tillë është zhvilluar në vitin 2018 kur kandidatura garonte për mandatin e tij të parë<sup>37</sup>. Ndërkohë**

---

<sup>36</sup> Neni 111, pika 4 - Rregullore Kuvendi. Kjo dispozitë mbetet e diskutueshme përsa kohë që bie në kundërshtim me nenet 26 pika 7 dhe 27 të Rregullores. Referuar normave juridike në fuqi programimi i punimeve parlamentare fokusohet rreth 3 mekanizmave: programit të punës (3-9 javor); kalendarit të punimeve (3-javor) dhe rendit të ditës në seancë plenare. Në programin e punës (dhe në zbatim të tij edhe në kalendar) duhet të përfshihen edhe kandidaturat për vendet vakante në institucione. Mbi bazën e kalendarit përcaktohet rendi i ditës për seancën plenare. Përsa më sipër, është i nevojshëm harmonizimi i neneve 26, 27 dhe 111 të Rregullores me qëllim përfshirjen e kandidaturave në Program dhe Kalendar.

<sup>37</sup> Shih: procesverbalin e komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut datë 21.2.2023 në linkun <https://web->

**Kuvendi ka mbajtur tjetër standard për kandidaturën për anëtar AKEP-i (KVPTM) e cila edhe kjo garonte për një mandat të dytë<sup>38</sup> duke zhvilluar seancë dëgjimore.**

4. Vlen të theksohet se, përgjithësisht, numri i deputetëve që angazhohen në këtë proces është i ulët dhe se fazat e shqyrtimit reduktohen vetëm në një prezantim shumë të shkurtër të përvojave personale nga ana e kandidatëve duke anashkaluar pyetjet dhe debatin parlamentar. KEF dhe KVPTM në zgjedhjen e kandidaturave të tyre, respektivisht, për anëtarë të KS (mars 2023)<sup>39</sup> dhe anëtarë të KDAKEP-it (shtator 2023) janë mjaftuar vetëm me një prezantim shumë të shkurtër të kandidatëve. Asnjë pyetje drejtuar kandidatëve, asnjë diskutim rreth plotësimit të kriterëve ligjorë<sup>40</sup>. Që të jetë efikas, procesi zgjedhës, kërkon angazhimin maksimal të të gjithë deputetëve ku barra e përgjegjësisë bie mbi relatorin dhe komisionin përgjegjës.

Një angazhim më i madh i tyre tregon prioritetin që i jep Kuvendi këtij procesi por njëkohësisht rrit besimin e publikut në këtë institucion dhe fuqizon transparencën. Pjesëmarrja e organit propozues, në veçanti e KM-së, në mbledhjen e komisionit është për tu adresuar. Për më tepër, një ndër kompetencat e ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamenti është edhe të kujdeset dhe të ndjekë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin në Kuvend të emërimeve që paraqiten me propozim të Këshillit të Ministrave apo ministrave përgjegjës, si dhe të kujdeset për respektimin e procedurave dhe të afateve ligjore për emërimet që i propozohen Kuvendit nga Këshilli i Ministrave apo ministri përgjegjës<sup>41</sup>.

1. Në respektim të rregullave të procedurës, për vlerësimin e kandidaturave komisioni bashkëpunon edhe me institucione të tjera për marrjen e informacioneve të nevojshme mbi aspekte të rëndësishme të figurës së kandidatit. Në kuadër të vlerësimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t'u emëruar apo zgjedhur në organe kushtetuese apo të krijuara me ligj, komisioni përkatës parlamentar, mbështetur në ligjin nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i kërkon të dhëna Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit për kandidatët e propozuar. Komisioni duhet ti kërkojë të dhënat përpara zgjedhjes/emërimit.

---

[api.parlament.al/Files/202303211209380632Komisioni%20i%20%20Ligjeve%201.2.2023.pdf](https://api.parlament.al/Files/202303211209380632Komisioni%20i%20%20Ligjeve%201.2.2023.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 27.9.2023)

<sup>38</sup> Shih: raportin e KVPTM datë 13.9.2023 "Për propozimin e Këshillit të Ministrave "Për emërimin e disa anëtarëve të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare" në linkun <https://web-api.parlament.al/Files/202309190902578125Raporti%20i%20komisionit%20p%C3%ABr%20Veprimtarit%C3%AB%20Prodhuese,%20Tregtin%C3%AB%20dhe%20Mjedisin%20.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 27.9.2023)

<sup>39</sup> Shih: Procesverbal, datë 28.3.2023 KEF në linkun <https://web-api.parlament.al/Files/202304251708006845Procesverbal%20KEF%20-%2028.3.2023.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 27.9.2023)

<sup>40</sup> Në shqyrtimin e kandidaturës për anëtar të KK-së, dy kandidatëve u janë drejtuar pyetje nga dy deputetë. Gjithashtu edhe në rastin e AKEP-it për dy kandidatë ka pasur pyetje nga tre deputetë.

<sup>41</sup> VKM nr. 27, datë 23.1.2019 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin" të ndryshuar" pikat III/16 dhe IV/8 - Fletore zyrtare nr. 6/2019 në linkun <https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2019/6/44de555b-2089-43d7-ac51-a9738af441cc> (Aksesuar për herë të fundit më 30.9.2023)

2. Me qëllim zgjedhjen e kandidatëve me integritet dhe ndalimin e personave të inkriminuar për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik, Kuvendi, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i kushton rëndësi të veçantë edhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga kandidati duke ia adresuar institucionit përkatës. Procesi i verifikimit, në çdo rast që është e mundur, duhet të synojë realizimin e tij në një kohë të mjaftueshme përpara emërimit në funksionin publik me qëllim administrimin e rregullt, transparencën dhe publikimin në kohë, kur kjo kërkohet, si dhe verifikimin e plotë e të gjithanshëm të të dhënave dhe nxjerrjen në kohë të përfundimeve të verifikimit, në funksion të pengimit të zgjedhjes apo emërimit.
3. Komisioni përgjegjës në përfundim të shqyrtimit të kandidaturave për pozicionet vakante në institucionet e pavarura përgatit raportin përkatës për në seancë plenare. **Aktualisht Kuvendi ka standardizuar me akte të brendshme raportin e komisionit në rastin e shqyrtimit të projektligjeve<sup>42</sup> si dhe raportin e komisionit në rastin e vlerësimit të veprimtarisë vjetore të institucioneve të pavarura<sup>43</sup>. Ndërkohë, nuk ka standardizuar raportin e komisionit në rastet e zgjedhjes dhe/ose emërimit të kandidaturave për në organe kushtetuese apo të krijuara me ligj.**
4. Në këto raste raporti (çështje për tu adresuar) duhet të përmbajë elementët e informimit, të shpjegimit, të analizës, të krahasimit me kuadrin ligjor ekzistues në vlerësimin e plotësisht të kriterëve kushtetuese dhe/ose ligjore të kandidaturës si dhe në vlerësimin substancial të meritës profesionale dhe përshtatshmërisë së kandidatit për pozicionin për të cilin garon. Këto lloj vlerësimesh janë të lidhura ngushtë me qëllimin e ligjvënësit për të zgjedhur figura që kanë integritet të lartë profesional dhe etiko-moral. Institucionet e pavarura janë me rëndësi kyçe në sistemet demokratike të qeverisjes dhe ky status kërkon vendosjen e standardeve të larta të profesionalizmit dhe integritetit. Në këtë raport duhet të gjejë pasqyrim edhe mendimi i opozitës nëse në komision ka patur divergjenca.
5. Pavarësisht se Kuvendi nuk ka standardizuar ende raportet e komisioneve në rastet e zgjedhjes së kandidaturave për institucionet kushtetuese dhe/ose të krijuara me ligj nga monitorimi i kryer rezulton se raportet aktuale nuk plotësojnë as standardet minimale të nevojshme për tu konsideruar si profesionale. Raportet paraqiten të cingëruara, joserioze dhe joprofesionale<sup>44</sup>. Raporti është produkt i punës së komisionit dhe si i tillë reflekton cilësinë e procesit. Mungon informacioni për kriteret ligjore që duhen plotësuar, se si është zbatuar procedura paraprake përzgjedhëse nga organi

---

<sup>42</sup> Urdhër i Sekretarit të Përgjithshëm nr. 29, datë 29.01.2019, "Për standardizimin e formatit të raportit të komisioneve për projektligjet".

<sup>43</sup> Shih: Manuali "Për monitorimin vjetor dhe periodik", formati i raportit të komisionit parlamentar, për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit në monitorim bashkëlidhur manualit në linkun

<https://staging.parlament.al/Files/Akte/20181227134148vendim%20nr.%20134,%20dt.%2020.12.2018.pdf>

(Aksesuar për herë të fundit më 28.9.2023)

<sup>44</sup> Në dhjetor 2022 KÇLAPDNJ shqyrtoi kandidaturat për anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Raporti i komisionit përbën një ndër rastet shumë të rralla ku raporti është profesional. Shih raportin në linkun <https://web-api.parlament.al/Files/202212201601410494Raporti%20i%20komisionit%20te%20ligjeve%20per%20kandidaturat%20per%20GJK%20vakanca%20e%20shpallur%20me%2016.01.2022.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 28.9.2023)

propozues, përvoja profesionale e kandidaturës, performanca gjatë seancës dëgjimore, pyetjet e drejtuara dhe përgjigjet e marra, mendimet e anëtarëve të komisionit (por edhe të OSHC-ve nëse ka patur) për kandidaturën në fjalë si dhe korrespondenca (nëse ka patur) me institucione të tjera dhe që kanë shërbyer për vlerësimin e kandidaturave<sup>45</sup>.

- 6. Nga monitorimi i ISP rezulton se në seancat dëgjimore të zhvilluara me kandidatët OSHC-të nuk ftohen të marrin pjesë<sup>46</sup>.** Përfshirjes së shoqërisë civile në proceset parlamentare i kushtojnë rëndësi të veçantë edhe organizata ndërkombëtare si Unioni Ndërparlamentar<sup>47</sup> apo Lëvizja Transparenca Ndërkombëtare<sup>48</sup>. *Referuar Transparency International OSHC-të mund të mbështesin procesin e verifikimit duke hetuar kualifikimin e kandidatëve bazuar në dokumentacionin e paraqitur, si kualifikimet akademike, ashtu edhe historinë e tyre profesionale ose personale që mund të ndikojnë në besueshmërinë e tyre për të kryer punën në mënyrë efektive, në mënyrë të paanshme dhe transparente<sup>49</sup>.* **Gjithashtu, roli i relatorit në verifikimin e përmbushjes së kriterëve kushtetuese dhe/ose ligjore si dhe vlerësimin të meritës së kandidaturës, paraqitet i zbehtë duke konfirmuar para komisionit thjesht plotësimin ose jo të kriterëve<sup>50</sup>.**

Kandidaturat e shqyrtuara në komisionin përgjegjës i referohen seancës plenare për diskutim dhe votim. Seanca plenare është forumi në të cilin kandidaturat për këto institucione marrin vëmendjen e publikut, dhe vendosin përpara përgjegjësisë si organin propozues ashtu edhe Kuvendin si organ të emërtesës.

1. Nga monitorimi i kryer nga ISP rezulton se **shqyrtimi reduktohet vetëm në votimin e kandidaturës duke anashkaluar komisionin përgjegjës dhe mbi të gjitha diskutimet e deputetëve për këtë çështje të cilat referuar rregullave të procedurës janë detyruese<sup>51</sup>.** Në disa raste kërkesat për diskutime nuk janë pranuar me arsyetimin se kandidaturat i nënshtrohen vetëm votimit dhe jo diskutimit<sup>52</sup>.

---

<sup>45</sup> Psh shih raportin e KEF për vlerësimin e kandidaturave për anëtarë të KS në linkun <https://web-api.parlament.al/Files/202304041610431728Raport%20KEF%20-%204%20anetaret%20e%20KS.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 28.9.2023)

<sup>46</sup> Shih procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve datë 21.2.2023 - KÇLAPDNJ; datë 13.9.2023 - KVPTM; datë 28.3.2023 - KEF etj.

<sup>47</sup> Shih Global Parliamentary Report 2022 në linkun <https://www.ipu.org/resources/publications/reports/2022-03/global-parliamentary-report-2022> (Aksesuar për herë të fundit më 28.4.2023) fq. 381

<sup>48</sup> Shih Civil society interventions to enhance parliamentary oversight. Transparency International - 2022 në linkun <https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/kproducts/CSO-interventions-to-enhance-parliamentary-oversight.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 27.9.2023)

<sup>49</sup> Shih Civil Society Interventions to Enhance Parliamentary Oversight - Transparency International 2022. <https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/kproducts/CSO-interventions-to-enhance-parliamentary-oversight.pdf> fq. 8 cit. (Aksesuar për herë të fundit më 27.9.2023)

<sup>50</sup> Shih fjalën e relatorit në rastin e kandidaturave për KS në procesverbalin e KEF datë 28.3.2023 fq. 6 në linkun <https://web-api.parlament.al/Files/202304251708006845Procesverbal%20KEF%20-%2028.3.2023.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 28.3.2023) ose fjalën e relatorit në rastin e kandidaturës për anëtar të Bordit të AMF-së në procesverbalin e KÇLAPDNJ datë 21.2.2023 fq. 41 në linkun <https://web-api.parlament.al/Files/202303211209380632Komisioni%20i%20%20Ligjeve%201.2.2023.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 28.9.2023)

<sup>51</sup> Neni 46/1 - Rregullore Kuvendi

<sup>52</sup> Shih: procesverbalin e seancës plenare datë 16.3.2023 fq. 90 në linkun <https://web-api.parlament.al/Files/202303241131247216Procesverbal,%20dat%20C3%AB%2016.3.2023.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 29.3.2023)

2. Në fjalorin juridik, por edhe referuar jurisprudencës kushtetuese termi “shqyrtim” nënkupton të drejtën dhe detyrimin e Kuvendit për ta bërë objekt diskutimi e debati çështjen në fjalë dhe për të marrë një vendim të caktuar për miratimin ose mosmiratimin e saj. Për më tepër një interpretim historik i nenit 48 të Rregullores (bazuar në krijimin e normës juridike dhe ndryshimet që ajo ka pësuar ndër vite) ndihmon në këtë drejtim<sup>53</sup>. Nga ana tjetër, përjashtimi nga diskutimet parashikohet në mënyrë taksative nga vetë Rregullorja. P.sh kërkesa e prokurorisë për dhënien e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, ose heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, për kontrollin personal ose të banesës është çështje e cila nuk është objekt diskutimi në seancë plenare.<sup>54</sup>
3. Për ta garantuar në mënyrë efektive këtë proces është shumë i nevojshëm zhvillimi i debatit mes forcave politike në Kuvend.

Mandati i titullarit ose anëtarit të organit drejtues të institucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj përcaktohet në Kushtetutë dhe/ose në ligjet e krijimit të këtyre institucioneve. Një mandat i plotë varion nga 4 vjet (Komisionerët e AP-së), 5 vjet (p.sh anëtarët-AMF) deri në 7 (p.sh anëtarët-KMBSH) apo 9 vjet (p.sh anëtarët-GJK). Disa ligje organike parashikojnë se *në rast të lirit nga detyra të ndonjërit prej anëtarëve të organit drejtues përpara afatit, mandati i fituar me vendim Kuvendi, zgjat vetëm për periudhën deri në përfundim të mandatit të anëtarit që lirohet*. P.sh anëtarët e Bordit Drejtues të AMF-së<sup>55</sup> ose anëtarët e AMA-s<sup>56</sup>.

1. Nuk ka një uniformitet për sa i përket kohëzgjatjes së mandatit në të njëjtin organ drejtues. Anëtarë të ndryshëm fitojnë mandate me kohëzgjatje të ndryshme megjithëse janë anëtarë të të njëjtit organ drejtues. Në ndonjë rast, ligji organik (sikurse ligji për AMF-në<sup>57</sup>) kushtëzon lirimin nga detyra të anëtarit për shkak dorëheqje me vendimmarrjen e Kuvendit.
2. Neni 8 parashikon se “Kuvendi vendos lirimin nga detyra të anëtarit të Bordit përpara afatit të parashikuar në rastet kur kandidati jep dorëheqjen. Heqja dorë nga mandati është veprim që bazohet në shprehjen e vullnetit individual, i cili duhet vetëm të respektohet dhe të mos bëhet objekt diskutimi dhe vendimmarrjeje nga ana e Kuvendit.

<sup>53</sup> Shënim: referuar dispozitave ligjore të nenit 48 të Rregullores, (përpara vitit 2019) koha e përcaktuar për diskutime dyfishohej (20’) në raste të përcaktuara, një ndër të cilat, ishte edhe rasti i zgjedhjes, emërimit, ose shkarkimit të titullarëve të organeve që zgjidhen nga Kuvendi duke nënkuptuar se për zgjedhjen e anëtarëve koha në dispozicion ishte 10 minuta.

<sup>54</sup> Shih nenin 118/4 - Rregullore Kuvendi

<sup>55</sup> Shih neni 8 i ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” të ndryshuar” në linkun [https://amf.gov.al/pdf/ligje/Ligjinr\\_95723\\_7\\_2006.pdf](https://amf.gov.al/pdf/ligje/Ligjinr_95723_7_2006.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 29.9.2023)

<sup>56</sup> Shih neni 12, pika 6 i ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar” në linkun <https://ama.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Ligj-nr.97-2013-P%3%abr-Mediat-Audiovizive-n%3%ab-Republik%3%abn-e-Shqip%3%abris%3%ab.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 29.9.2023)

<sup>57</sup> Shih: Ligji nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” të ndryshuar” në linkun [https://amf.gov.al/pdf/ligje/Ligjinr\\_95723\\_7\\_2006.pdf](https://amf.gov.al/pdf/ligje/Ligjinr_95723_7_2006.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 30.9.2023)